

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7816
E shtunë, 22 qershor 2024
Çmimi 0.50 €

Reka takohet me
ambasadoren e ShBA-së në
OKB në kuadër të debatit
mbi të ardhmen e politikës
së jashtme amerikane | **FAQE 5**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

E KUJT ËSHTË PËRGJEGJËSIA PËR HAPJEN E URËS SË IBRIT?



FAQE 4-5

Tema e hapjes së urës kryesore mbi lumin Ibër ka përcjellë shumë qeveri në Kosovë dhe diplomatë të huaj, ndërsa


vazhdon të diskutohet edhe sot. Në Kuvendin Komunal të Mitrovicës së Veriut bëhet thirrje që ura të hapet, por

faktori ndërkombëtar bën thirrje për bashkëpunim në çdo hap. Kush e ka fjalën e fundit për hapjen e saj?

**HOXHAI:
KURTI DHE
VUÇIQI PO
E PËRDORIN
VERIUN PËR TA
KONSOLIDUAR
PUSHTETIN** **F. 5**



**BISLIMI E NJOFTON NDIHMËSSEKRETARIN
E OKB-së PËR AVIONËT LUFTARAKË SERBË
PËRRETH KUFIRIT ME KOSOVËN** **F. 3**




RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SPORT



**HOXHA: SPANJA E JASHTËZAKONSHME,
POR NE DUAM KUALIFIKIMIN HISTORIK** **F. 10**

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ShBA-ja do ta furnizojë Ukrainën me raketa të mbrojtjes ajrore

Uashington, 21 qershor - Shtëpia e Bardhë ka njoftuar se do t'i japë përparësi dërgimit në Ukrainë të raketave të fuqishme të mbrojtjes nga ajri, pasi një seri sulmesh ruse me raketa dhe dronë kanë dëmtuar objekte energjetike në të gjithë

Ukrainën. Qindra raketa të sapoproduhuara të tipit "Patriot" dhe "NASAMS" që përdoren për mbrojtjen tokë-ajër do të dërgohen në Ukrainë përpara vendeve të tjera që i kanë porositur ato, ka thënë John Kirby, zëdhënësi i Shtëpisë së

Bardhë për Sigurinë Kombëtare. Ai ka thënë se dërgesat e planifikuara për Tajvanin dhe Izraelin nuk do të ndikohen nga kjo lëvizje dhe se vendet e tjera që prisnin dërgesat ishin "gjerësisht mbështetëse" kur janë informuar për vendimin e Uashingtonit.



Shqipëria, Mali i Zi, Bosnja dhe Kroacia përballen me ndërprerje të rrymës

Prishtinë, 21 qershor - Shumë qytete në Shqipëri, Mal të Zi, Bosnjë-Hercegovinë dhe Kroaci janë përballur me ndërprerje të energjisë elektrike më 21 qershor.

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) në Shqipëri ka thënë se shkaktarët e ndërprerjes së rrymës kanë qenë volumet e larta të transmetimit dhe temperaturat ekstreme, që kanë shkaktuar defekte në linjën e interkoneksionit me Greqinë. "Defekti ka filluar nga linja e interkoneksionit me Greqinë dhe më pas ka vazhduar me efekt kaskadë në të gjithë vendin", ka thënë OST përmes

një njoftimi duke shtuar se po merren masa për rikthimin e energjisë elektrike për të gjithë konsumatorët.

Edhe sistemi për shpërndarjen e rrymës në Mal të Zi ka njoftuar përmes një postimi në "Facebook" se ka ndërprerje të energjisë elektrike dhe se pothuajse i tërë vendi është pa rrymë.

Ndërkaq drejtori i Kompanisë së Energjisë Elektrike në Republikën Serpska, Luka Petroviq, i ka thënë "Radios Evropa e Lirë" se arsyeja e ndërprerjes së rrymës në pothuajse tërë territorin e Bosnjës është për shkak të një "problemi në rrjetin e energjisë



në Mal të Zi". Autoritetet në Republikën Serpska thanë se

presin që situata me energji të stabilizohet shpejt.

Edhe Kroacia ka njoftuar se disa pjesë të vendit janë përballur me ndërprerje të rrymës, përdërisa autoritetet kroate, së bashku me homologët e tyre në shtetet fqinje, thanë se po analizojnë shkakun e ndërprerjes së rrymës.

Nga Kompania e Furnizimit me Energji Elektrike të Kosovës (KESCO) kanë konfirmuar për "Radios Evropa e Lirë" se nuk ka probleme me furnizim me energji elektrike në Kosovë. Probleme me rrymë nuk janë raportuar as në Serbi dhe Maqedoni të Veriut. Ditët e fundit Kosova është përballur me temperatura mbi 35 gradë celsius.

Armenia njeh shtetin palestinez

YEREVAN, 21 QERSHOR - Armenia zyrtarisht ka njohur shtetin palestinez, ka bërë me dije Ministria e Jashtme e këtij shteti përmes një deklarate për medie më 21 qershor. Armenia është bërë shteti i fundit që njeh shtetin palestinez pavarësisht prej kundërshtimeve nga Izraeli. Jerevani mbështet rezolutën e Kombeve të Bashkuara për një armëpushim të menjëhershëm në luftën në mes të Izraelit dhe Hamasit – grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian, në Gazë dhe mbështet zgjidhjen mes dy shtete në konfliktin izraelit-palestinez, është thënë në deklaratë. Armenia ka theksuar se "jemi sinqerisht të interesuar që të



vendoset paqja afatgjatë dhe stabiliteti në Lindjen e Mesme". Jerevani, që vetë ka qenë i përfshirë në konflikt në Azerbajxhanin fqinj për dekada të tëra, ka dënuar ofensivën ushtarake të Izraelit në Gazë.

"Armenia shpreh keqardhje për përdorimin e infrastrukturës civile si mburojë gjatë konflikteve të armatosura dhe dhunës karshi popullatës civile", ka thënë Ministria e Jashtme. Në deklaratë, po ashtu, është

thënë se Jerevani shpreh keqardhje për marrjen e pengjeve civile nga Hamasi dhe "u bashkohemi kërkesave të komunitetit ndërkombëtar për t'i liruar ata".

Autoriteti Palestinez, që ushtron vetëqeverisje të kufizuar në Bregun Perëndimor – që gjendet nën pushtimin izraelit - ka mirëpritur vendimin e Armenisë.

"Kjo njohje kontribuon pozitivisht në ruajtjen e pozitdhjes me dy shtete e cila përballlet me sfida sistematike dhe promovon sigurinë, paqen dhe stabilitetin për të gjitha palët e përfshira", është thënë në deklaratën e presidencës së Autoritetit Palestinez.

Ky vendim i Jerevanit ka nxitur zemërim në Izrael, shtet që ka

ftuar në bisedë ambasadorin armen.

Spanja, Irlanda dhe Norvegjia janë në mesin e shteteve perëndimore që zyrtarisht e kanë njohur shtetin palestinez muajin e kaluar, duke nxitur Izraelin që t'i tërheqë ambasadorët nga Madridi, Dublini dhe Oslo.

Njoftimi për njohjen e shtetit palestinez vjen në kohën kur lufta në Gazë po vazhdon. Lufta nisi pasi Hamasit sulmoi jugun e Izraelit më 7 tetor, duke vrarë afër 1 200 persona dhe duke rrëmbyer afër 250 të tjerë. Si pasojë e ofensivës izraelite, në Gazë janë vrarë më shumë se 37 000 persona dhe pothuajse e gjithë popullsia, prej 2.3 milionë banorësh e kësaj enklave, është zhvendosur.

Japonia miraton sanksione të reja kundër Ruisë

Tokio, 21 qershor - Japonia ka vendosur sanksione të reja ndaj 42 kompanive ruse, por edhe ndaj 11 subjekteve me bazë në pesë vende, përfshirë Kinën dhe Indinë, për ndihmën e Moskës për t'iu shmangur masave ndëshkuese në lidhje me konfliktin në Ukrainë. Vendimi i Tokios vjen pas deklaratave të bëra nga

kryeministri japonez Fumio Kishida në samitin e G7-s në Itali në fillim të këtij muaji, sipas të cilit, qeveria e tij po shqyrtonte një "paketë të re masash ndëshkuese" në vendet e treta, e cila përfshinte ngrirjen e mallrave dhe ndalimin e eksportit.

Pesë vendet e raportuara përfshijnë gjithashtu Emiratet e

Bashkuara Arabe, Uzbekistanin dhe Kazakistanin dhe kompanitë në listën e zezë përfshijnë Alrosa, një kompani ruse e minierave të diamanteve dhe prodhuesit e avionëve Tupolev dhe Ilyushin.

Sanksionet japoneze, të futura në disa faza që nga fillimi i armiqësive, kanë të bëjnë me më shumë se 1 000 persona

dhe mbi 150 subjekte ruse, përveç miratimit të listës së mallrave dhe teknologjive të ndaluara për eksport në Federatën Ruse, e cila tashmë përmban rreth 800 artikuj.

"Japonia do të vazhdojë të punojë me anëtarët e G7-a dhe komunitetin ndërkombëtar" për të siguruar respektimin e sanksioneve kundër Ruisë, ka



thënë në një konferencë për medie sekretari i kabinetit japonez, Yoshimasa Hayashi.

Si e rrezikon shëndetin i nxehti ekstrem?



REUTERS

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Me të nxehtin ekstrem që ka kapluar shumicën e hemisferës veriore gjatë kësaj jave, autoritetet dhe ekspertët e shëndetit publik kanë lëshuar paralajmërime për të nxehtët, në mënyrë që njerëzit të jenë të sigurt.

Pjesë të Kinës, Indisë, Lindjes së Mesme, jugut të Evropës dhe Shteteve të Bashkuara po përballen me mundësinë që të shënojnë nivele të reja rekorde të temperaturave.

Cilat janë rreziqet shëndetësore?

I nxehti ndikon në shëndet në disa mënyra.

Lodhja nga temperaturat e larta, përfshirë marramendjen, kokëdhimbjen, dridhjen e trupit dhe etjen, mund të prekin këdo dhe zakonisht këto simptoma nuk janë serioze nëse një person freskohet brenda 30 minutash.

Një gjendje më serioze shëndetësore është një sulm nga të nxehtët. Kjo nënkupton se temperatura trupore e një personi shkon mbi 40.6 gradë celsius. Një gjendje e tillë konsiderohet emergjencë mjekësore dhe mund të shkaktojë

dëme afatgjata në organe dhe vdekje. Simptomat përfshijnë frymëmarrje të përshpejtuar, hutim apo konvulsione dhe të vjella.

Përderisa ndryshimet klimatike në vitet e ardhshme do të vazhdojnë të rrisin temperaturat, rreziku i lagështisë po ashtu pritet të rritet. Ajri më i nxehtë mund të mbajë më shumë lagështi. Dhe më shumë lagështi në ajër ua bënë më të vështirë njerëzve që të djersiten, në mënyrë që të ulin temperaturën e trupit.

Kush është në rrezik?

Disa njerëz janë më të cenueshëm, përfshirë foshnjat dhe të moshuarit, por edhe personat që duhet të jenë aktivë apo që janë më të ekspozuar ndaj temperaturave të larta, sikurse janë të pastrehët.

Sëmundjet paraprake, përfshirë sëmundjet e frymëmarrjes dhe ato kardiovaskulare, por edhe diabeti, po ashtu mund të rrisin rrezikun dhe të përkeqësohen si pasojë e të nxehtit. Shumë shtete nuk e regjistrojnë të nxehtin si arsye specifike e vdekjes, që nënkupton se nuk ka statistika për rrezikun e temperaturave të larta te këto komunitete.

Megjithatë, një studim i The

Lancet i vitit 2021 vlerësoi se më pak se gjysmë milion vdekje mund t'i atribuohen temperaturave të larta çdo vit - një llogaritje konservatore që nuk përfshin të dhëna nga shumë shtete me të ardhura të ulëta. Shumë në Evropë kanë frikë se do të përsëritet vera e vitit 2022, gjatë së cilës valët e të nxehtit vranë 61.000 persona, thanë shkencëtarët.

Rreziku do të vazhdojë të rritet pasi ndryshimet klimatike në dekadat në vijim pritet të rrisin edhe më shumë temperaturat.

Rreziqet më pak të dukshme

Përveç testimit të temperaturës së brendshme të trupit, i nxehti ekstrem mund të paraqesë edhe rreziqe të tjera sekondare.

Temperaturat më të nxehta inkurajojnë rritjen e baktereve dhe algave. Prandaj, valët e të nxehtit mund të rrisin rrezikun e kontaminimit të ujit me sëmundje sikurse kolera apo që mjediset ujore të ngufaten nga algat toksike.

I nxehti po ashtu mund të dëmtojë të mbjellat, duke rritur shqetësimet lidhur me sigurinë ushqimore.

Duke nisur nga viti 2030, ekspertët presin që numri i vdekjeve në botë

do të rritet nga 250.000 në vit si rezultat i katër rreziqeve shëndetësore që lidhen me klimën: stresi nga të nxehtët, kequshqyerja e lidhur me pasigurinë ushqimore, malaria dhe diarreja, sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH). Zjarret e nxitura nga pemët dhe shkurret e thara mund të çojnë në nivele të rrezikshme të ndotjes së ajrit, e cila më pas mund të shkaktojë inflamacion në mushkri dhe dëme të tjera shëndetësore. Studimet po ashtu kanë sugjeruar se i nxehti ekstrem, por edhe ekspozimi ndaj tymit të zjarreve mund të jenë të lidhura me lindjet e foshnjave me nënpeshë dhe para kohe.

Stresi nga të nxehtët po ashtu mund të kontribuojë në përkeqësim të shëndetit mendor. Rritja e temperaturave gjatë natës mund të shkaktojë telashe me gjumin, duke përkeqësuar shëndetin mendor.

Koha ka rëndësi

Ekspertët thonë se më shumë vdekje ndodhin në fillim të verës kur trupat e njerëzve nuk kanë shans të ambientohen me sezonin.

Edhe vendndodhja ka rëndësi. Njerëzit përballen me rrezik më të lartë nëse jetojnë në vende ku nuk

janë mësuar me të nxehtë ekstrem. Këtu përfshihen edhe pjesë të Evropës.

Teksa puna në ambiente të jashtme bëhet e rrezikshme për shkak të temperaturave të larta, disa shteteve dhe komunitete kanë mbyllur shkollat apo kanë reduktuar orarin e punës gjatë ditës për bizneset.

Çfarë mund të bëni?

Agjencitë e shëndetit publik nga India dhe ShBA-ja kanë publikuar këshilla për t'u mbrojtur nga temperaturat e larta, ku përfshihet edhe shmangia e sforcimit dhe pirja e ujit.

Autoritetet shpesh synojnë të ndihmojnë qytetarët duke ngritur qendra për freskim, duke shpërndarë ujë apo duke ofruar qasje në transport publik të pajisur me sistem të kondicionimit të ajrit.

Punëtorët duhet të bëjnë më shumë pauza apo të ndërrojnë rrobat, thanë shkencëtarët.

Sipas tyre, është e rëndësishme që të shtohet kujdesi ndaj grupeve të cenueshme, sikurse janë të moshuarit.

Sulmi nga i nxehtët është emergjencë shëndetësore dhe kërkon trajtim të menjëhershëm profesional.

(Përgatiti: Mimoza SADIKU)



E kujt është përgjegjësia për hapjen e urës së Ibrit?

Tema e hapjes së urës kryesore mbi lumin Ibër ka përcjellë shumë qeveri në Kosovë dhe diplomatë të huaj, ndërsa vazhdon të diskutohet edhe sot. Në Kuvendin Komunal të Mitrovicës së Veriut bëhet thirrje që ura të hapet, por faktori ndërkombëtar apelon për koordinim në çdo hap. Kush e ka fjalën e fundit për hapjen e saj?

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Simbol i ndarjes dhe vend i tensioneve janë vetëm dy nga mënyrat se si është përshkruar ndër vite ura kryesore mbi lumin Ibër, e cila ndan Mitrovicën në dy komuna. Për dikë, hapja e saj është edhe simbolikë dhe çështje tërësisht politike, pasi qytetarët gjejnë rrugë alternative për të kaluar nga një zonë në tjetrën. Diskutimet për urën janë aktualizuar në javët e fundit, pas thirrjeve në Kuvendin Komunal të Mitrovicës së Veriut që ura të hapet tërësisht për qarkullim. Këtë komunë në veri të Kosovës e udhëheq Erden Atiq nga partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje. Kryetari i Kuvendit Komunal të Mitrovicës së Veriut, Nexhad Uglanin, pati thënë se zbatimi i vendimit për çështjen e urës u takon autoriteteve qendrore dhe institucioneve të sigurisë. Zyrtarë të këtij Kuvendi patën thënë se hapja e urës është edhe nën juridiksion të Mitrovicës së Jugut dhe të misionit paqeruajtës të Organizatës së

Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) në Kosovë, KFOR. Radio Evropa e Lirë ka tentuar të marrë një koment të zyrtarëve komunalë të Mitrovicës së Jugut, por ata nuk kanë qenë të qasshëm. Edhe zëvendësudrejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani, pati paralajmëruar në maj se ura “do të hapet shpejt” dhe se po diskutohet me eprorët se si të bëhet kjo. Faktori ndërkombëtar, në anën tjetër, po kërkon vazhdimisht të ketë koordinim mes të gjitha palëve të prekura që të mos përshkallëzohet situata. Ish-drejtori i Policisë së Kosovës, njëherësh deputet opozitar në Kuvendin e Kosovës, Rashit Qalaj, thotë për Radion Evropë e Lirë se vendimi për hapjen e urës i takon Qeverisë së Kosovës, por se nuk beson që ajo mund të veprojë asisoj pa koordinim me faktorin ndërkombëtar, sidomos me KFOR-in. “Nëse Qeveria e Kosovës merr vendim,

frikësohem që nuk do të zbatohet nga KFOR-i”, shprehet ai.

Karabinierët italianë të KFOR-it kanë prani të përhershme mbi urën e Ibrit dhe kryejnë patrullime në rrethinë. Ura vëzhgohet edhe prej pjesëtarëve të Policisë së Kosovës.

Qeveria e Kosovës beson se liria e lëvizjes duhet të sigurohet në të gjithë territorin, por Serbia e konsideron hapjen e urës si “provokim”.

Kronologjia e zhvillimeve rreth urës

- Pas luftës së viteve 1998/’99, kjo urë e ndau qytetin e Mitrovicës në pjesën jugore me shumicë shqiptare dhe në atë veriore me shumicë serbe.

- Plani i Ahtisaarit, baza mbi të cilën Kosova e shpalli pavarësinë e saj më 2008 – parashikoi ndarjen e Mitrovicës në dy komuna të veçanta.

- Më 2011, serbët lokalë vendosën aty barrikatat e para, për të kundërshtuar shtrirjen e autoriteteve të Kosovës.

- Më 2013 u formua Komuna e Mitrovicës së Veriut, sipas ligjeve të Kosovës.

- Më 2014, barrikatat u zëvendësuan me copa betoni dhe me pemë. Pamja e re u quajt “Parku i Paqes”. Po atë vit, Kosova dhe Serbia arritën marrëveshje në Bruksel për heqjen e barrikadave dhe për

rivalizimin e urës.

- Më 2015 u hoq Parku i Paqes, me idenë e hapjes së urës për qarkullim.

- Më 2016, palët në Bruksel u pajtuan për një plan zbatimi të marrëveshjes për urën.

- Rivitalizimi i urës u përfundua nga Bashkimi Evropian më 2018 dhe kushtoi rreth 1.5 milion euro.

Aktualisht, ura mbetet e hapur për këmbësorë, por jo edhe për automjete.

Një tjetër problem për hapjen e urës ka qenë edhe konteksti për kufijtë komunalë.

“Ura e mbyllur për shkak të Serbisë, jo serbëve të Kosovës”

Rashit Qalaj e sheh hapjen e urës si problem politik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, i cili ka potencial të shndërrohet në problem të sigurisë. Sipas tij, përshkallëzimi i situatës varet prej qëndrimit të Serbisë, jo prej serbëve të Kosovës. “Mënyra më e mirë do të ishte që ura të hapet në koordinim me mekanizmat ndërkombëtarë të sigurisë, sidomos me KFOR-in. Ndoshta për një periudhë kohore të shkurtër, trafiku aty të monitorohet nga Policia e Kosovës, ndërsa afër të qëndrojnë njësitet e KFOR-it”. Qalaj beson se koordinimi është kyç dhe duhet të jetë në linjë me marrëveshjen e arritur në

Bratislavë mes Kosovës dhe BE-së, një vit më parë, për shtensionimin e situatës në veri të Kosovës, pasi kryetarët shqiptarë morën drejtimin e katër komunave.

Marrëveshja e korrikut të vitit 2023 përcaktoi se Qeveria e Kosovës “nuk do të ndërmarrë asnjë veprim që mund të përshkallëzojë situatën në veri të Kosovës”.

Radio Evropa e Lirë e ka pyetur Qeverinë e Kosovës nëse i ka kërkuar KFOR-it ta hapë urën, mirëpo nuk ka marrë përgjigje.

Në të njëjtën pyetje, Zyra për media e NATO-s i është referuar vetëm komunikatës së lëshuar pas takimit të 18 qershorit mes komandantit të KFOR-it, Ozkan Ulutash, dhe të dërguarit të BE-së për dialogun Kosovë-Serbi, Miroslav Lajçak. Në të është bërë thirrje që secili vendim për urën të diskutohet në Bruksel.

Por, Qalaj, i cili ka qenë vetë pjesëtar i ekipit negociator të Kosovës kur është diskutuar për urën, vlerëson se nëse për këtë temë bisedohet në kuadër të dialogut, hapja e urës do të shtyhet.

Shqiptarët në Mitrovicë të Jugut dhe serbët në Mitrovicë të Veriut - me të cilët ka biseduar Radio Evropa e Lirë - janë të ndarë nëse ura duhet të hapet.

Për shqiptarët, hapja e urës do të ishte “gjë e mençur”, ndërsa për serbët vendim që rrit tensionet.

Reka takohet me ambasadorin e ShBA-së në OKB në kuadër të debatit mbi të ardhmen e politikës së jashtme amerikane

NJU-JORK, 21 QERSHOR - Shefi i Misionit në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Nju-Jork, ambasador Blerim Reka, është takuar me përfaqësuesen e

përhershme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB), Linda Thomas Greenfield. Reka ka thënë se me

ambasadorin amerikane është takuar në kuadër të debatit mbi të ardhmen e politikës së jashtme amerikane. "Me ambasadorin Linda Thomas Greenfield, përfaqësuese e përhershme e

ShBA-së në OKB, mbrëmë në debatin në NCAFP, mbi të ardhmen e politikës së jashtme amerikane dhe multilateralizmin", ka shkruar Reka në "Facebook".



Bislimi e njofton ndihmëssekretarin e OKB-së për avionët luftarakë serbë përreth kufirit me Kosovën

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Kosovës, Besnik Bislimi, ka pritur në takim ndihmëssekretarin e përgjithshëm të OKB-së për Evropën, Azinë Qendrore dhe Amerikën, Miroslav Jenca. Zëvendëskryeministri Bislimi e ka njoftuar atë për situatën në vend dhe rajon, për objektivat e qeverisë dhe për të arriturat në tri vitet e fundit. Ai ka theksuar se Kosova është duke u avancuar dhe zhvilluar me ritëm të shpejtë pavarësisht prej barrierave me të cilat përballet. Sipas të dhënave më të fundit nga ASK-ja, Bislimi ka thënë se tremujori i parë i këtij viti ka shënuar rritje ekonomike në nivelin 5.62 për qind. "Edhe projeksionet e Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar për vitet e ardhshme, si dhe rankimet ndërkombëtare të Kosovës në shumë fusha, qëndrojnë si dëshmi e progresit të vendit tonë", citohet të këtë thënë Bislimi.



Zëvendëskryeministri Bislimi ka theksuar se rritja e BPV-së, rritja e punësimit, sundimi i ligjit,

integrimi në Bashkimin Evropian dhe anëtarësimi në organizata ndërkombëtare, janë

synime qenësore për qeverinë. Në vazhdim është diskutuar edhe mbi procesin e dialogut, ku

zëvendëskryeministri Bislimi e ka njoftuar ndihmëssekretarin Miroslav Jenca me zhvillimet e fundit, "duke shprehur konstruktivitetin dhe angazhimin e vazhdueshëm të palës sonë në këtë proces, i cili është përballur me destruktivitetin dhe mungesën e vullnetit e gatishmërisë për hapa tutje e zbatim të marrëveshjeve nga pala tjetër".

"Mbi qasjen destruktive dhe kërcënimin e vazhdueshëm që Serbia paraqet për Kosovën, zëvendëskryeministri rikujtoi se fqinji ynë verior ka 48 baza të përpame operacionale përreth kufirit me Kosovën, në vazhdimësi mban ushtrime e stërvitje të mëdha ushtarake pak kilometra larg kufirit me shtetin tonë dhe fluturon avionët luftarakë 'MIG 29' përreth kufirit", ka njoftuar Qeveria e Kosovës.

Ndërsa ndihmëssekretari Miroslav Jenca është duke zhvilluar një tur ballkanik, ndalesë e radhës e së cilës është vendi ynë, ku do të qëndrojë në një vizitë dyditore.

Hoxhaj: Kurti dhe Vuçiqi po e përdorin veriu për ta konsoliduar pushtetin



PRISHTINË, 21 QERSHOR - Nënkrjetari i Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së, Enver Hoxhaj, ka folur për situatën në veri të Kosovës dhe çështjen e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Hoxhaj ka thënë se kryeministri Albin Kurti në këto tri vjet të qeverisjes ka luftuar komplet në vijë të kundërt të trendëve ndërkombëtare dhe ndryshimeve gjeopolitike, duke e përdorur veriu e Kosovës si platformë për ta konsoliduar pushtetin e tij. "Me luftën në Ukrainë, me luftën në Gaza, me një luftë të mundshme në Tajvan, po shpërbëhet rendi

ndërkombëtar dhe zoti Kurti ka luftuar komplet, në vijë të kundërt të trendëve ndërkombëtare, të ndryshimeve gjeopolitike dhe, mbi të gjitha, ka vendosur që në emër të një politike, sa më shumë ta konsolidojë pushtetin e tij të brendshëm duke përdorur veriu e Kosovës si një platformë për ta konsoliduar pushtetin e tij", ka thënë Hoxhaj. Ish-ministri i Punëve të Jashtme i Kosovës ka thënë se situata e veriut të vendit i shërben për të qenë në pushtet Albin Kurtin në Prishtinë dhe Aleksandër Vuçiqin në Serbi. Hoxhaj ka theksuar se PDK-ja asnjëherë nuk e ka

përdorur situatën në veri të vendit për popullizëm politik. "Ne kemi vepruar në raport me veriun e Kosovës, duke shpërbërë struktura paralele, duke luftuar krimin dhe krimin e organizuar në veri të vendit, duke bërë çdo gjë që ta përmbysim shtetndërtimin e Kosovës në veri të vendit, duke integruar komunitetin serb. Ne asnjëherë nuk e kemi përdorur situatën e veriut të Kosovës për popullizëm politik. Kjo se çfarë po ndodh në veri të vendit nuk është në përputhje me interesin nacional të shtetit të Kosovës", ka thënë Hoxhaj. /Telegrafi

Selimi citon një ekspert të lartë: Serbia i ka shitur Ukrainës predha me vlerë 700-900 milionë euro

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Ish-ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Petrit Selimi, ka folur rreth luftës në Ukrainë. Duke cituar një ekspert të lartë dhe "të mirë informuar", ai ka thënë se Serbia i ka shitur Ukrainës

predha me vlerë në mes të 700 dhe 900 milionë eurove. "Një ekspert i lartë i mirinformuar për Ukrainën e NATO-n më tha se Serbia i ka shitur Ukrainës predha me vlerë mes 700 e 900 milionë euro, duke ofruar

rreth 30 për qind të të gjitha predhave të artilerisë në luftën e saj për t'u mbrojtur nga Rusia. Nëse kjo qëndron, mund të thuhet se Vuçiqi me këtë e bleu kënaqësinë nga Perëndimi", ka shkruar Selimi në platformën "X".



IDENTITETI I USHTRISË ÇLIRIMTARE DHE I KOSOVËS



Dr. Sc. Aferdita
DERVISHI-DEDOLLI

Çështje të përkufizimit

Nëse flitet për identitetin e dy a më shumë palëve, që është në këtë rast, a mund të thuhet se ka dyfishim të identiteteve, që ose e përjashtojnë njëri-tjetrin, ose janë të ndërthurur deri në atë masë, sa nuk mund të flitet për identitete të ndryshme. Prandaj, identiteti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, është lufta e saj çlirimtare, kurse rrjedhja e asaj lufte është liria e kësaj pjese të atdheut, që quhet Shqipëri, sepse Shqipërisë i janë shkëputur pjesë të tokave, që i kanë marrë pushtues të ndryshëm.

Atëherë, cili është identiteti i Kosovës, sidomos pas Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës? Identiteti kombëtar i saj, zë fill që në shekullin XV-të, me luftërat afro 30 vjeçare të Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriotit Skënderbeut, po ashtu që në kohën e ekzistimit të Vilajeteve shqiptare, më tutje, edhe me formimin e krahut ushtarak të Lidhjes Shiptare të Prizrenit, si dhe ishte përmbyllur me shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, më 1912, nga Ismail Qemali. Do të thotë, identitetin kombëtar të saj, nuk e ka përcaktuar Lufta e UÇK-së. Identiteti i UÇK-së, ka krijuar hapësirë, po ashtu në marrëveshje me fuqitë e mëdha botërore, të krijohet identiteti shtetëror i Kosovës, i cili si proces historik në rrugën e bashkimit kombëtar, është hapur me Luftën e UÇK-së.

Hyrje

Kur çështjet shtrohen në këtë rrafsh, atëherë mund të thuhet se këto dy identitete, ai i Luftës së UÇK-së, dhe ai i Kosovës, nuk kanë të njëjtin taban historik, por kanë të njëjtin zgjidhje politike. Identiteti i UÇK-së, pra, edhe i luftës së saj çlirimtare, gjatë zhvillimit të saj, gjatë organizimit të saj, edhe në frontet e luftës, ka pasur rëniet dhe ngritjet, të shumtën të kushtëzuar edhe nga rrethanat e brendshme, edhe nga faktorët e jashtëm.

Rrethanat e brendshme ishin pasojë e gjendjes okupuese të Kosovës, por ishin edhe pasojë e kuptimeve të ndryshme të rrugëve për bërjen e lirisë.

Faktorë të rëndësishëm të brendshëm, pra faktorë brenda Kosovës dhe brenda hapësirës shqiptare, nuk e pranoinin as luftën çlirimtare, as ushtrinë që bënte këtë luftë çlirimtare, pra Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, siç është quajtur që në fillimin e organizimit të saj në luftën frontale.

Më tutje, si pasojë e pushtimit të gjatë, Kosova nuk kishte as shtet, as pushtet, edhe pse sot e gjithë ditën shtresa të caktuara shoqërore derdhen lot krokodili, për atë që është prishur e nuk po rregullohet asnjëherë, në kohën e vëllazërimit dhe bashkimit socialist, duke i rënë telit të mendësisë se liria do të vinte pa luftë, se do të vinte nga qielli, apo nga diku jashtë, apo siç e ka thënë Holbrook, nga një supremen, e nuk do të kishte nevojë të derdhej tërë ai gjak e të shkatërrohej gjithçka në Kosovë.

Faktori i jashtëm, sidomos qendrat e vendosjes evropiane, duke bërë përpjekje që ta ruanin qetësinë e tyre, pra të Evropës, njësoj si edhe në vitin 1913, kur ishte përgjakur copëtimi i tokave shqiptare, nuk hezitonte ta quante edhe konflikt të brendshëm, nuk hezitonte të kërkonte nga ata që ishin vetëshpallur si përfaqësues të Kosovës, që të disiplinoheshin formacionet ushtarake, të mos vriteshin policia dhe ushtria jugosllave, pastaj ajo serbo-malazeze, të mos shkeleshin konventat ndërkombëtare, si dhe e drejta ndërkombëtare, se shteti që e konsideronte Kosovën pjesë të veten, kishte të drejtë edhe të bënte masakra, kur brenda atij territori shtetëror, shapallej padëgjueshmëri qytetare.

Qendrat evropiane të vendosjes, duke ruajtur lëkurën e vetë, nuk merreshin fare me zgjidhjen e çështjes shqiptare, të cilën e kishin krijuar vetë, siç nuk merren as sot, e nuk do të merren as nesër, sidomos nëse SHBA heq dorë nga projekti i saj për zgjidhjen e çështjes shqiptare.

Prandaj, identiteti i Kosovës është çështje që kërkon zgjidhje, sipas të drejtës historike të popullit shqiptar, sepse siç po shihet, identiteti shtetëror nuk mjafton për të përmbyllur procesin e bashkimit kombëtar, që ishte ideologjia identifikuese e Luftës së UÇK-së.

Një ushtri që bënte luftë çlirimtare pa shtet dhe pa pushtet

Historiani ushtarak Alan Millett, pohon se identiteti i luftëtarit është pjesërisht i trashëguar dhe pjesërisht i vetë-zhvilluar. Veprimtarët e devotshëm të çështjes kombëtare, në kushte dhe rrethana të jashtëzakonshme, në kohë të rënda plumb, e formuan Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, dhe, aty e gjetën veten e tyre si ushtar të një ushtrie, pa shtet dhe pa pushtet.

Nëse ky konstatim qëndron, gjë që e thonë edhe faktet historike të zhvillimit të ngjarjeve në atë kohë, atëherë çka ishte kjo ushtri që bënte luftë çlirimtare? Ishte një ushtri e dalë nga populli, sidomos nga shtresa atdhetare e popullit, e organizuar në mënyrë vullnetare, pa shtet, sepse Kosova ishte e pushtuar dhe nuk ishte shtet, si dhe pa pushtet, sepse pushteti që thuhej se ekzistonte brenda Kosovës, nuk e kishte mbështetjen e krahut të luftës, rrjedhimisht nuk e kishte mbështetjen e shtresave më të gjera të popullit.

Këtë e dëshmon një fakt i vetëm historik, ai i daljes publike të UÇK-së, në varrimin e mësuesit Halit Geci. Ata që kanë përcjellë ato skena, nuk mund të shkelin mbi faktin e gatishmërisë së shtresave të popullit që të përballeshin me armikun.

Po ashtu, fjalja që është thënë aty, se ky popull tashti e tutje e ka forcën e vetë që i mbron, e ka ushtrinë e vetë, dëshmon për identitetin çlirimtar të saj. Do të thotë, deri atëherë Kosova nuk kishte një forcë që mund të dilte para popullit dhe të thoshte se tashti e tutje, ka kush u mbron nga pushtuesi.

Në këtë rrafsh, identiteti i UÇK-së, përveç karakterit çlirimtar të luftës, që në fronte fillon më 1997, ka edhe karakter të identitetit kombëtar, sepse që në Betimin e Ushtarit, kishte përcaktuar karakterin e saj kombëtar- çlirimtarin e të gjitha pjesëve të pushtuara të atdheut dhe bashkimin e tyre me shtetin amë, Shqipërinë. Përkatesisë së këtyre të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nuk mund t'i hiqen as fjalët, as shenjat e pikësimit, ngase nëse do të ndodhte të hiqej diçka, atëherë përkufizimi bëhet i njënjshëm me qendra të caktuara të Evropës plakë, që e ka quajtur konflikt të brendshëm.

Do të thotë, as konflikt në mes dy

grupeve kombëtare, në mes dy grupeve, që historikisht ishin në armiqësi shekullore, sepse serbi tokat e huaja i kishte marrë dhe i konsideronte të vetat, pa asnjë të drejtë historike, kurse grupi tjetër etnik, shqiptarët pra, me Ushtrinë e tyre çlirimtare, luftonin për ta korriguar këtë padrejtësi historike. Në anën tjetër të këtij përkufizimi, është vënë identiteti i Kosovës, pa ndonjë argumentim të mbshtetur në fakte historike, përveç nëse kërkohet që në shekullin XXI të krijohet një komb i ri, ai kosovar, që është kundër historik, që mohon ekzistencën e kombit shqiptar, i cili është formuar në të njëjtin shekull si dhe kombet e tjera të botës moderne.

Identiteti i Kosovës është vetëm identitet shtetëror

Pse mund të thuhet kështu? Ka disa arsye, të cilat edhe në dijen tonë historike, por edhe në trajtesa të veçanta, as nuk përmendet sa duhet, as nuk përkufizohet drejtë. Arsyet janë të shumta, por disa janë vendimtare, që do të preken këtu, pa u lodhur shumë, radhitën sipas meritës së vlerës, apo pa pasur ngarkesë se i bien dikujt tamam, apo nuk i bien.

Së pari, Kosovën e kanë njohur shtet kryesore të botës, fuqitë më të mëdha, ato që ishin bërë krahë i Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Por, ato shtete ishin bërë krahë i luftës, kur Kosova nuk ishte ende shtet.

Së dyti, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë kishte dhënë përgjigje pozitive në kërkesën e Serbisë, se Kosova nuk mund të bëhej shtet, së paku pa e pyetur Serbinë.

Së treti, Kosova ka mbajtur disa palë zgjedhje të lira, edhe sipas vlerësimit të qendrave evropiane, në të cilat janë përfshirë edhe komunitetet pakicë me të drejta më të mëdha se kudo në Evropë, ngase Kosova nuk guxonte të bashkohej me asnjë shtet fqinj, thuhet ajo do të bashkohej me drejtin e të birin, e jo me shtetin amë, Shqipërinë.

Së katërti, qoftë edhe vetëm ky përkufizim, se nuk ka të drejtë të bashkohet me asnjë vend fqinj, dëshmon për dy rrafshet e ndryshme identitetesh. Për rrafshin e parë të identitetit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si bartëse e idealit kombëtar, që historikisht ka hapur procesin e madh historik të bashkimit kombëtar, i cili një ditë, doemos do të realizohet, qoftë edhe vetëm për hir të padrejtësive

historike që i janë bërë popullit shqiptar. Për rrafshin e dytë të identitetit të Kosovës, së cilës nuk i njihet identiteti i saj kombëtar, por aq më keq, nuk ka të drejtë të bashkohet me shtetin amë, Shqipërinë.

Kush mund ta shpjegojë këtë logjikë të qendrave evropiane të vendosjes, mund të ketë rastin të bëhet njohësi më i mirë i përpjekjeve të Evropës në procesin e Bashkimit Evropian.

Përfundim

Ushtria e dalë nga populli, promovoi rregulla e norma etike të sjelljes, gatishmëri për të bërë sakrificën sublime për kombin e për tokën arbërore andaj ishte bërthama e bërjes së lirisë. Në përkufizimet e deritashme del se identiteti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, është çlirimi i pjesëve të pushtuara të atdheut tonë, Shqipërisë.

Kosova nuk mund të përkufizohet si atdhe i shqiptarëve, sepse kështu kanë vendosur fuqitë e mëdha, sepse ndryshe do të kërkohej bashkimi kombëtar, gjë që e pengonte, siç e pengon edhe sot e nesër, sidomos Evropën, me atë politikën e saj të kritereve të dyfishta.

Më tutje, udhëheqës të shqiptarëve, në këto 25 vjet pas Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si dhe pas Luftës së UÇPMB dhe të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, sa herë në fushata zgjedhore kanë përmendur bashkimin kombëtar, të nesërmen janë tërhequr nga deklaratimet e tyre, qoftë nën trysinë evropiane, qoftë nga mendësia e tyre fisnore, sepse u mjaftonin gjysmat e pjesët që u kishin lënë të tjerët. Sido që të jetë bashkimi kombëtar nuk bëhet me deklarata as me fjalë, por bëhet me veprim konkret, që duhet të fillojë nga unifikimi i kutikulave shkollore për të vazhduar tutje. Prandaj, argumentohet se politika që zhvillohet në jetën e shqiptarëve, nuk është politikë e bashkimit kombëtar. Kurse lufta që ka bërë Ushtria Çlirimtare e Kosovës, ka hapur procesin e madh historik të bashkimit kombëtar. Nëse realizohet ky projekt, që një ditë do të realizohet doemos, atëherë mund të flitet edhe për identitetin e këtyre dy rrafshëve, të Kosovës dhe të UÇK-së, si rrjedhje normale e proceseve historike, në të cilët janë korrigjuar padrejtësitë historike të shkaktuara, edhe nga faktori i brendshëm, edhe nga ai ndërkombëtar.

Rama takohet me anëtarët e Bordit të Drejtorëve të BERZh-it, paraqiten plane për transformimin e kryeqytetit

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Kryetari i kryeqytetit, Përparim Rama, së bashku me nënkryetarin Alban Zogaj, mirëpritën në takim anëtarët e Bordit të Drejtorëve të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), të cilët përfaqësojnë shtetet anëtare nga Evropa, Amerika, Azia dhe Afrika. Gjatë takimit, kryetari Rama

falënderoi BERZh-in për përkrahjen e vazhdueshme në reformimin e Trafikut Urban dhe prezantoi plane dhe projekte të ndryshme për transformimin e kryeqytetit. Ai theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të mëtijshëm me BERZh-in për realizimin e këtyre projekteve në Prishtinë, duke kërkuar mbështetjen e tyre në këtë

drejtim.

Pas takimit, Rama dhe anëtarët e Bordit të Drejtorëve të BERZh-it vizituan ndërmarrjen publike lokale Trafiku Urban. Ata u njohën nga afër me punën që po kryhet në këtë ndërmarrje dhe diskutuan për planet për vazhdimin e reformimit të plotë të ndërmarrjes dhe linjave të autobusëve.



Gjykata Themelore anulon vendimin për projektin në Gërmi

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Qendra për Raste Gjyqësore Strategjike (CLS) ka bërë me dije se Gjykata Themelore në Prishtinë ka miratuar padinë që ajo ngriti së bashku me organizatën joqeveritare "Qytetarët Aktivë" dhe ka anuluar vendimin e komunës së Prishtinës për projektin "Parku i Aventurave". "Parku i Aventurave" ishte paraparë të ndërtohej në parkun e mbrojtur të Gërmisë, por me vendimin e fundit, Themelorja ka anuluar vendimin për lejen mjedisore për realizimin e projektit. Paraprakisht, më 2021 Gjykata Supreme e Kosovës kishte vendosur të shtyhej ekzekutimi i vendimit të komunës së Prishtinës lidhur me këtë projekt

deri në një vendim përfundimtar për këtë rast. "CLS e vlerëson sukses tejet të rëndësishëm vendimin e Gjykatës Supreme mbi pezullimin e lejes mjedisore të projektit 'Parku i Aventurave' dhe vendimin e fundit të Gjykatës Themelore për anulimin e vendimit për realizimin e këtij projekti. Vendimet e tilla konfirmojnë kundërligjshmërinë e ndjekur nga organet publike, mohimin e të drejtës kushtetuese të qytetarëve për pjesëmarrje në vendimmarrjen mjedisore dhe rrezikun për degradimin e natyrës nga projekte të tilla si 'Parku i Aventurave', ka njoftuar GLS-ja. Themelorja ka konstatuar se komuna e Prishtinës gabimisht ka aplikuar bazën ligjore për



lëshimin e lejes mjedisore për këtë projekt, përkatësisht është thirrur në një udhëzim administrativ për dhënien e

lejeve mjedisore komunale. Por, projekte të tilla, sikurse "Parku i Aventurave", sipas CLS-së, rregullohen me Ligjin për

vlerësimin e ndikimit në mjedis. "Gjykata i ka vlerësuar të drejta argumentet se komuna e Prishtinës gjatë vlerësimit dhe miratimit të Projektit 'Parku i Aventurave' ka shkelur garancitë kushtetuese të qytetarëve duke ia mohuar të drejtën e pjesëmarrjes në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ata jetojnë", ka njoftuar GLS-ja. "Parku i Aventurave" ishte paraparë të përfshinte një sipërfaqe prej rreth 70 ari dhe të shtrihej nga Butovci në drejtim të parkut të Gërmisë. Kur ishte paraqitur si projekt, komuna e Prishtinës kishte thënë se parku do të ndërtohej duke përdorur metoda speciale që do ta shmangnin dëmtimin e drurëve në Gërmi.

Projektligji për KPM-në kalon në seancë plenare për lexim të dytë, kërkohet të dërgohet dhe Komisioni i Venecias



PRISHTINË, 21 QERSHOR - Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal ka shqyrtuar Projektligjin për Komisionin e Pavarur për Media (KPM). Raporti i përbërë me 93 amendamente është votuar me gjashtë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim që të kalojë në seancë plenare për një lexim të dytë. Një nga anëtarët e këtij

komisioni, deputeti Mërgim Lushtaku, ka ngritur si rekomandim, dërgimin në lexim edhe të Komisionit të Venecias. "Të dërgojmë dhe Komisionin e Venecias, një projektligj i rëndësishëm së veçantë, që ka të bëjë me median e lirë", ka thënë Lushtaku. Edhe anëtari tjetër, deputeti Agim Veliu, e ka përkrahur rekomandimin e tij që Komisioni i Venecias të shkojë për diskutim.

Ndërsa kryetari i këtij komisioni, Valon Ramadani, ka thënë se në këtë mbledhje nuk ka kohë për shqyrtimin e këtij projektligji në Komisionin e Venecias. "Jam i bindur se do të kalojë si ligj dhe është në rregull, por ne nuk kemi kohë të shkojmë me Komisionin e Venecias", ka thënë Ramadani. Përpos opozitës, ky projektligj është kundërshtuar nga AGK-ja, shoqëria civile dhe ndërkombëtarët.

Bordi i RTK-së emëron Aleksandra Jovanoviqin drejtoreshë të RTK 2

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Me tetë vota për dhe asnjë kundër Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës (RTK) ka emëruar Aleksandra Jovanoviqin për drejtoreshë të kanalit në gjuhën serbe, respektivisht në RTK2. Vendimi për votimin nga Bordi erdhi pas përfundimit të procesit të përzgjedhjes, përkatësisht rekomandimit nga Grupi Punues për përzgjedhjen e drejtorit të RTK2 bazuar në Ligjin për RTK-në dhe rregullativën e brendshme.

Bordi pret që Jovanoviqi, e cila ka një bagazh të pasur në gazetari dhe televizion, ta forcojë pozitën e kanalit RTK 2 në treg si kanal televiziv lider për komunitetin serb. Bordi i RTK-së, gjithashtu, falënderon të gjithë kandidatët që morën pjesë në procesin e përzgjedhjes dhe rikonfirmon përkushtimin e tij për respektimin e standardeve më të larta të profesionalizmit dhe integritetit në punë. Procedurat e zgjedhjes së drejtorit të RTK2 përcaktohen

në Ligjin për RTK-në, i cili në nenin 35 të tij e ngarkon Bordin e RTK-së për themelimin e një grupi punues të jashtëm, i cili e bën vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve. Ky grup përbëhet nga shtatë anëtarë, ku katër prej tyre janë të komunitetit serb, dy nga komuniteti shqiptar si dhe një nga komunitetet e tjera joshumicë, të cilët duhet të jenë të gjithë politikisht të pavarur dhe përfaqësues të shoqërisë civile ose ekspertë të mediave.



ATK-ja publikon broshurën "Trajtimi tatimor i furnizimeve elektronike"

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Administrata Tatimore e Kosovës ka njoftuar lidhur me përmbushjen vullnetare të detyrimeve tatimore të cilat rrjedhin nga furnizimet elektronike. Ajo ka publikuar broshurën "Trajtimi tatimor i furnizimeve elektronike". Kjo broshurë është përgatitur me qëllim të informimit publik se si trajtohen për qëllime tatimore aktivitetet e realizuara në mënyrë elektronike dhe e njëjta u dedikohet të gjithë personave që zhvillojnë aktivitet në mënyrë

elektronike, përfshirë edhe qytetarët që janë blerës të mallrave dhe shërbimeve në mënyrë elektronike. "Në një vend modern, që Kosova synon të jetë, nga qytetarët kërkohet pagesa e tatimeve dhe obligimeve tjera të përcaktuara me ligj. Andaj edhe personat që zhvillojnë aktivitet ekonomik në mënyrë elektronike, në bazë të legjislacionit tatimor të Kosovës, janë të obliguar të regjistrohen, mbajnë dokumentacion, deklarojnë dhe paguajnë tatimin", ka njoftuar ATK-ja. Përmes kësaj broshure të

gjithë personat do të informohen për aktivitetet ekonomike që realizohen në mënyrë elektronike; dallimet mes tregtisë tradicionale dhe tregtisë elektronike; personat që kryejnë furnizime të mallrave dhe shërbimeve në mënyrë elektronike; ofrimin e shërbimeve në mënyrë elektronike; përcaktimin e vendit të furnizimit të mallrave dhe shërbimeve për aspekte të TVSh-së; lëshimin e kuponit fiskal për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve në mënyrë elektronike.



Në afatin njëjavor priten sugjerimet dhe rekomandimet për Projektligjin për krypto-asetet

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, drejtuar nga Mimoza Kusari-Lila, kryesuese e grupit punues, ka mbajtur dëgjim publik lidhur me Projektligjin për krypto-asetet. Nën kryetarja Kusari-Lila kronologjikisht shpalosi procedurat e deritanishme në të cilat ka kaluar ky projektligj, duke specifikuar rëndësinë e dëgjimit publik për t'i marrë rekom-

andimet, sugjerimet dhe kritikën lidhur me këtë projektligj. Në këtë dëgjim publik ishin të pranishëm përfaqësues nga Banka Qendrore e Kosovës, Njësia për Inteligjencë Financiare, përfaqësues nga kompania Cactus, përfaqësues nga ATK-ja, Dogana e Kosovës, Oda Ekonomike Amerikane, KEDS, Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare, Oda Tregtare Kosovare Turke. Disa nga përfaqësuesit e institucioneve dhe kompanive të sipërpërmendura parashtruan



një sërë pyetjesh lidhur me transparencën, autorizimin, operimin, transaksionet dhe mbrojtjen e të dhënave që prek ky projektligj.

Monitorimi dhe mbikëqyrja e kryptoasteve në Kosovë, kriteret e autorizimit dhe licencimit, ishin tema me interes diskutimi. Si rrjedhojë, anëtarët e komisionit parashtruan qëndrimet e tyre, duke theksuar se nëpërmjet dëgjimit publik sigurohet efektshmëria edhe më e madhe e këtij projektligji dhe pasurohet fusha legjislative që rregullon aspektin e kripovalutave në vend. Me theks të veçantë u përmend rëndësia e Bankës Qendrore të Kosovës në licencim, autorizim

dhe mbikëqyrje të operatorëve dhe rëndësia e Njesisë së Inteligjencës Financiare në monitorimin dhe lëvizjen e transaksioneve dhe mbështetjen e implementimit të projektligjit në tërësi. Duke e konsideruar projektligjin si hap pozitiv drejt rregullimit të fushës së krypto-asteve, nënkryetarja Kusari-Lila, ripotencoi afatin njëjavor për ridërgimin e komenteve me shkrim, të cilat do të shqyrtohen nga grupi punues i Projektligjit për krypto-asetet.

Mbahet takimi vjetor me Suedinë, u diskutua për projekte të ndryshme

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Në ndërtesën e Qeverisë së Kosovës u zhvillua takimi vjetor me Suedinë. Delegacioni i Kosovës kryesohej nga zëvendëskryeministri i Parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Republikës së Kosovës, Besnik Bislimi. Pjesëmarrës ishin dhe ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, ministri i Bujqësisë, Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, zëvendëskryeministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Arbër Vokri, zëvendëskryeministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Jeton Raka



dhe zyrtarë të tjerë nga kabinetet qeveritare e zyrtarë civilë. Nga ana tjetër, delegacioni suedez

kryesohej nga ambasadori i Suedisë në Kosovë, Jonas Westerlund, e ku pjesëmarrës ishin

dhe përfaqësues të tjerë të lartë të ambasadës suedeze në Kosovë. Gjatë takimit u diskutua mbi kontributin e Suedisë në zhvillimin e Kosovës, pasqyrën e strategjisë së bashkëpunimit zhvillimor të Suedisë, si dhe prioritetet e fushat e fokusit për periudhën 2021-2027. U trajtuan më tej më gjerësisht projektet e iniciativat ekzistuese dhe të mundshme në të ardhmen, me ndikim në të drejtat e njeriut, demokracinë, sundimin e ligjit, barazinë gjinore, gjithëpërfshirjen, zhvillimin e qëndrueshëm dhe mjedisin si dhe zhvillimin ekonomik. Zëvendëskryeministri Bislimi e falënderoi shtetin suedez për

ndihmën dhe përkrahjen e vazhdueshme për Kosovën. "Takimet e tilla vjetore janë mundësi e thellimit të partneritetit tonë, meqenëse ato shërbejnë për t'i reflektuar arritjet e deritanishme, sfidat gjatë zbatimit të projekteve si dhe diskutimit të mundësive që paraqiten për të ardhmen", u shpreh zëvendëskryeministri. Në vijim ai nënvizoi synimin strategjik për rritjen e ndikimit të projekteve të ndryshme, duke i ndërlidhur ato edhe me reformat të cilat po i ndërmarrim në kontekst të procesit të integritimit evropian dhe të zhvillimit të vendit.

Statistikat e hotelerisë, më shumë vizitorë në vitin 2023 sesa një vit më parë

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Departamenti për Statistikat Ekonomike, ka përgatitur publikimin vjetor të Statistikave të Hotelerisë për vitin 2023. Në kuadër të hulumtimit të Hotelerisë dhe Turizmit, në vitin 2023 numri i vizitorëve (vendorë dhe të huaj) ishte 621 486, prej tyre 42,4 % ishin

vendorë dhe 57,5 % ishin të jashtëm. Numri i net-qëndrimeve ishte 1,547,462, prej tyre 51,7 % nga vendorët dhe 48,2 % nga të huajt. Në vitin 2023 numri i vizitorëve vendorë është rritur për 61,9 % në raport me vitin 2022, net-qëndrimet e vizitorëve vendorë janë rritur për 199 %. Kemi rritje të vizitorëve të jashtëm për rreth 20,2 %,

kurse net-qëndrimet e vizitorëve të jashtëm janë rritur për 37 % në raport me vitin 2022. Numrin më të madh të vizitorëve të brendshëm e ka regjioni i Pejës me 86 470 vizitorë dhe me 409 293 net-qëndrimi. Sa iu përket vizitorëve të huaj krahasuar me periudhën paraprake (2022) ka një rritje të vizitorëve për



20,2 %. Në total 357 717 vizitorë të huaj, nga të cilët numri më i madh është nga Shqipëria, Gjermania, Zvicra,

Turqia etj. Numri i individëve që kanë pasur të paktën 1 udhëtim me net-qëndrimi brenda apo jashtë Kosovës është 713 532. Të dhënat e mëposhtme janë të grumbulluara nga pikat kufitare, ku numri total i vizitorëve të jashtëm që kanë hyrë në territorin e Republikës së Kosovës gjatë periudhës janar - dhjetor 2023 ishte 6 416 443.

NATO me udhëheqje të re: Lidhjet e Mark Ruttes me Kosovën ndër vite



Te kryeministri i Holandës, Mark Rutte, autoritetet në Kosovë shohin një partner me të cilin mund të bisedojnë për një gamë të gjerë çështjesh – nga avancimi i vendit në rrugën drejt integritetit në Bashkimin Evropian deri te siguria dhe stabiliteti afatgjatë. Në krye të Qeverisë holandeze nga viti 2010, Rutte pritet të konfirmohet në pozitën e sekretarit të përgjithshëm të NATO-s brenda ditësh. Vizitën e fundit në Kosovë e zhvilloi korrikun e kaluar, kur së bashku me homologun e atëhershëm nga Luksemburgu, Xavier Bettel, i bënë thirrje Kosovës dhe Serbisë që t'i ulnin tensionet dhe t'i ktheheshin dialogut për normalizimin e marrëdhënieve, shkruan REL. Tensionet mes dy vendeve ishin në kulm, pasi në komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës, pushtetin e morën kryetarët e zgjedhur shqiptarë. “U bëjmë thirrje të dyja palëve që të marrin pjesë në dialogun e udhëhequr nga Bashkimi Evropian, ta shtensionojnë situatën dhe përfundimisht t'i normalizojnë marrëdhëniet”, shkroi Rutte atëkohë në platformën X.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e cilësoi takimin me dy udhëheqësit evropianë si mundësi për të diskutuar “përpjekjet për forcimin e bashkëpunimit, avancimin në rrugën drejt BE-së dhe përkushtimin e përbashkët për paqen, sigurinë dhe stabilitetin afatgjatë në kontinent”. Holanda ishte në mesin e shteteve që e njohën pavarësinë e Kosovës brenda muajit të parë pas shpalljes, më 2008. Atëkohë kryeministër ishte Jan Peter Balkenende. Rutte mori detyrën e kryeministrit mbi dy vjet më vonë – në tetor të 2010-ës. Në dhjetor të 2013-ës, ai priti në zyrën e tij presidenten e atëhershme të Kosovës, Atifete Jahjaga, së cilës i shprehu mbështetjen e Holandës për Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit mes Kosovës dhe BE-së. Kjo marrëveshje – e para kontraktuale mes dy palëve – u nënshkrua në vitin 2015. Qeveria e Ruttes, për një periudhë të caktuar, ishte kundërshtarë e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës, së bashku me atë të Francës. Një qëndrim i tillë i nxiti dhjetëra


deputetë të Parlamentit Evropian t'i shkruanin letër Ruttes dhe presidentit të Francës, Emmanuel Macron, në vitin 2020, për t'iu kërkuar dritën jeshile për lëvizjen e lirë të kosovarëve. Nga ajo kohë, procesi kaloi në disa faza dhe vizat u hoqën nga 1 janari i këtij viti. Presidentja e Kosovës, Osmani, takoi për herë të fundit Rutten këtë javë, në margjina të një samiti për paqen në Ukrainë, që u mbajt në Zvicër. “Samiti ishte një mundësi e shkëlqyer për të biseduar me kryeministrin holandez, Mark Rutte, për rëndësinë e së ardhmes euroatlantike të Kosovës”, shkroi Osmani në X. Këta dy udhëheqës u takuan edhe në samitin e Komunitetit Politik Evropian, i cili u mbajt në tetor të vitit të kaluar në Granadë të Spanjës. Osmani tha se në atë takim është folur për situatën e sigurisë në Kosovë, pas sulmit të armatosur të një grupi serbësh në pjesën veriore të vendit. Në 2021-shin, ata patën një shkëmbim edhe në Asambleenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, me ç'rast Osmani tha se është mirënjohëse për

“mbështetjen dhe bashkëpunimin” e Ruttes.

Si e arriti Rutte majën e NATO-s?

Sekretarët e përgjithshëm të NATO-s zgjidhen me konsensus nga të 32 vendet anëtare. Ruttes iu hap rruga pasi vende si Hungaria, Sllovakia dhe Rumania – përkundër hezitimeve fillestare – dhanë dritën jeshile. Për pozitën u përfolën edhe emra të tjerë, si ai i presidentit rumun, Klaus Iohannis, apo i kryeministres estoneze, Kaja Kallas, por nuk shkuan përpara. Rutte pritet ta marrë zyrtarisht detyrën më 1 tetor, nga shefi i deritashëm i NATO-s, Jens Stoltenberg. Rutte, 57 vjeç, është aleat i Ukrainës dhe kritik i ashpër i presidentit rus, Vladimir Putin. Ai ka qenë një nga mbështetësit më të mëdhenj të ndihmës ushtarake evropiane për Ukrainën, prej se Rusia ka nisur pushtimin në shkallë të plotë të saj në vitin 2022. Mundja në fushëbetjeje e Ruisë është jetike për të siguruar paqen në Evropë, thotë Rutte. Nën udhëheqjen e tij, Holanda i ka

rritur shpenzimet e mbrojtjes në më shumë se 2% të bruto prodhimit të brendshëm – prag ky që u kërkohej të gjitha vendeve anëtare të NATO-s. Rutte do të tërhiqet zyrtarisht nga pozita e kryeministrit kur Qeveria holandeze e kraut të djathtë ta zëvendësojë koalicionin e tij të qendrës së djathtë – me gjasë brenda disa javësh. Rutte, fillimisht, ka lënë të kuptohet se mund t'i pëlqejë të ligjërojë pas politikës, por, më pas, ka përmendur luftën në Ukrainë si arsye përse ka kërkuar një post ndërkombëtar. Stoltenberg tha këtë javë se Rutte është një kandidat “shumë i fortë” për ta zëvendësuar atë. Nën Stoltenbergun, i cili mori detyrën e shefit të NATO-s në vitin 2014, aleanca ushtarake u zgjerua me katër anëtarë të rinj: Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Finlandën dhe Suedinë. Nën udhëheqjen e tij, NATO-ja përforcoi edhe misionin e saj paqeruajtës në Kosovë vitin e kaluar, pas rritjes së tensioneve në veriun e banuar me shumicë serbe, ndërsa Asambleja Parlamentare e aleancës miratoi avancimin e statusit të Kosovës nga anëtare vëzhguese në anëtare të asociuar.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Hoxha: Spanja e jashtëzakonshme, por ne duam kualifikimin historik

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Futbollisti i Kombëtares së Shqipërisë, Arbër Hoxha, ka folur për ndeshjen që kuqezinjtë luajtën baras ndaj Kroacisë (2-2), por edhe për sfidën e radhës dhe të fundit në fazën e grupeve ndaj Spanjës. Ish-futbollisti i Istogut dhe Ballkanit, që tash djersitë fanellën e Dinamo Zagrebit, ka thënë se Shqipëria është paraqitur mirë ndaj kroatëve, por tash fokusi është në përballjen e së hënës ndaj Spanjës. “Në ndeshjen e dytë kemi luajtur shumë më mirë se ndaj Italisë. Shënuam, pësuam, por nuk u dorëzuam. Tashmë e kemi harruar atë ndeshje dhe jemi

fokusuar te përballja e radhës ndaj Spanjës. Të gjithë e dimë që Spanja ka një grup të jashtëzakonshëm. Pamë ndeshjen ndaj Italisë dhe ishin të shkëlqyer. Na mbetet të përgatitemi mirë dhe të arrijmë një kualifikimin historik përballë tyre, asgjë tjetër nuk ka rëndësi”, ka thënë Hoxha, i cili ka premtuar se do ta japë maksimumin për aq sa minuta në dispozicion. “Vendi i titullarit është një motiv shtesë për të vazhduar përpara, megjithatë gjithçka e vendos trajneri. Në fushë u futa për ta ndihmuar skuadrën, krijuam rastin e dytë që e shënuam, patëm sërish mundësi shënimi, por nuk arritëm ta shfrytëzonim”, ka deklaruar Hoxha. Lidhur me dy futbollistët më të rrezikshëm të Spanjës, Hoxha ka



thënë se ata janë Rodry e Nico Williams. “Ndaj Spanjës duhet të jemi të fokusuar 100 %. E dimë të gjithë që është një ekip që e mban topin gjithë kohës nën kontroll dhe e vetmja mënyrë është të luftojmë

nëpërmjet kundërsulmeve. Spanja është një nga ekipet më të mira të Evropianit dhe ne do të përgatitemi sa më mirë për këtë ndeshje. Nga ndeshja në ndeshje kemi treguar përmirësim. Ndaj Kroacisë bëjmë

një lojë totalisht të kundërt me Italinë dhe shpresojmë të bëjmë mirë edhe ndaj Spanjës, pavarësisht se këta kanë lojtarë të fortë si Rodry e Nico Williams”, ka shtuar ai. Hoxha ka folur edhe për ngritjen e madhe që ka prej se është transferuar te klubi gjigant i Kroacisë, Dinamo Zagreb. “Që prej janarit kur kalova te Dinamo kam parë një progres të vazhdueshëm te vetja. Në mars erdha për herë të parë te Kombëtarja dhe grumbullimi në Evropian ishte një emocion i papërshkrueshëm”, ka deklaruar futbollisti nga Istogu. Shqipëria nga dy ndeshjet e zhvilluara ka grumbulluar vetëm një pikë, kurse ndeshjen ndaj Spanjës e zhvillon të hënën nga ora 21:00.

Suhareka vazhdon kontratat me ndihmëstrajnerin Simnica dhe portierin Ymeri



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Skuadra e Suharekës, e cila në edicionin e ri do të bëjë gara në Superligën e Kosovës në futboll, po vazhdon përgatitjet për edicionin debutues në elitë. Kjo skuadër e ka vazhduar bashkëpunimin me ndihmëstrajnerin Armend Simnica dhe portierin Arion Ymeri. “Armend Simnica vazhdon me klubin tonë si ndihmëstrajner i Shpëtim Duros për edicionin e ardhshëm. Simnica u bashkua me klubin në edicionin

pranveror dhe kontribuoi shumë në përgatitjen e skuadrës duke qenë shumë profesional”, thuhet në njoftimin e skuadrës së Suharekës. Ndërsa portieri Ymeri do të jetë pjesë e kësaj skuadre deri në vitin 2026. “Ymeri ishte gardiani kryesor i portës sonë. Paraqitjet e tij kanë bërë që diferenca e golave të pranuar të ishte shumë e vogël, sidomos stinori pranveror, ku ishte fantastik me pritjet e tij”, thuhet në njoftim. Skuadra e Suharekës ka bërë edhe ndryshime të tjera në këtë afat

kalimtar. Ka angazhuar trajnerin e mirënjohur dhe shumë të suksesshëm nga Shqipëria, Shpëtim Duron në krye të skuadrës, derisa ndihmëstrajner është angazhuar edhe Debatik Curri, ish-trajner i Prishtinës dhe futbollist i Kombëtares së Shqipërisë. Ndërsa futbollistët e rëndësishëm si kapiteni Yll Hoxha, Donat Hasanaj, Arvanit Rexhaj, Ilir Syla dhe Mevlan Zeka kanë vazhduar kontratat. Si përforcime kanë ardhur deri tash Fitim Susuri, Eneid Kodra, Nikola Stijepović, Alden Skrijelj Lorik Boshnjaku Hysen Memolla.

Ekspertët e statistikave zbulojnë përqindjet për kualifikimin e Shqipërisë



TIRANË, 21 QERSHOR - Shqipëria ka shanse kualifikimi në fazën me eliminim direkt në “Euro 2024” por, me sa duket, ekspertet e statistikave e shohin si pak të mundshëm. Nëpërmjet 20 mijë simulimeve kompjuterike të rezultateve, ekspertët e “Football Meets

Data” kanë përcaktuar se cilat janë përqindjet që kanë kuqezinjtë për t’u pozicionuar në një vend apo një tjetër në grup. Sipas tyre, Shqipëria ka vetëm 2 % mundësi që të dalë në vendin e dytë në grup pas ndeshjeve të treta që do të luhen të hënën. Sipas

simulimeve kompjuterike, me 36 % mundësi Shqipëria del e treta, ndërsa ka 62 % mundësi të dalë e katërta. Në total, ekspertët përlllogaritnin se Shqipëria ka vetëm 8 % mundësi që të kualifikohet në fazën e 16 skuadrave më të mira.

‘AS’: Daku do të dënohet nga UEFA

MADRID, 21 QERSHOR - UEFA po heton thirrjet kundër Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut nga tifozët kroatë dhe shqiptarë. Organizata më e lartë ndërkombëtare do ta hetojë edhe sjelljen e pretenduar të papërshtatshme të lojtarit

shqiptar Mirlind Daku, i cili, pas ndeshjes, e cila përfundoi barazim 2-2, përdori megafonin dhe shoqëroi thirrjet e tifozëve. Mediumi spanjoll “AS” raporton se dy federatat do të gjobiten me para, kurse Daku do të

suspendohet për disa ndeshje dhe nuk do të luajë ndaj Spanjës. “UEFA ka njoftuar se në orët në vijim do të ketë një vendim për këtë çështje, por normale është që të dyja federatat marrin një sanksion të konsiderueshëm

financiar dhe Daku me siguri do të dënohet me disa ndeshje, ndaj nuk do të luajë kundër Spanjës të hënën e ardhshme. Shqipëria duhet të fitojë për të kaluar në fazën tjetër”, thuhet në artikullin e “AS”.



Klinsmann: Shqipëria ka ekip me cilësi

DORTMUND, 21 QERSHOR - Legjenda e Gjermanisë, Jurgen Klinsmann, i ka vlerësuar pozitive paraqitjet e Shqipërisë në "Euro 2024". Në një lidhje të drejtpërdrejtë për "ESPN"-në, trajneri gjerman ka thënë se kuqezinjtë kanë

një ekip plot me cilësi. Pavarësisht se i mungojnë emrat e mëdhenj, sipas tij, Shqipëria është një ekip që mund të shqetësojë të tre kundërshtarët në Grupin B. "Ky është grupi i vdekjes, me Spanjën, Italinë dhe

Kroacinë, dhe Shqipëria ka një ekip plot me cilësi. Shumica e lojtarëve luajnë në Serinë A, në Itali, dhe vërtet që mund t'ju shqetësojnë. Këtë janë duke bërë. Shqetësuan shumë Italinë dhe tani shqetësuan

Kroacinë. Kështu do të bëjnë edhe në ndeshjen e fundit me Spanjën. Është një ekip i mirë. Nuk ka një emër të madh ose lojtarë me emra të mëdhenj, por kanë cilësi. Kështu që nuk u befasoja shumë", ka thënë Klinsmanni.



Daku kërkon falje për sharjet pas ndeshjes me Kroacinë

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Futbollisti i Shqipërisë, Mirlind Daku, ka kërkuar falje për fyerjet që ka bërë pas ndeshjes me Kroacinë në Kampionatin Evropian "Euro 2024". Në një shkrim në "Facebook", Daku ka thënë se fyerjet e tij kanë qenë afekt i lojës. "Ndjesë nëse kam fyer dikë pas ndeshjes me Kroacinë. Afekti i lojës e bën të vetën. Unë vazhdoj të punoj së bashku me gjithë grupin rreth ëndrrave tona. Falja është burrërore, dhe e ndiej obligim moral dhe profesional ta bëj një gjë të tillë, për gjithë ata që janë lënduar", ka shkruar ai në "Facebook".

Në postimin në "Facebook", Daku ka shprehur falënderime për përkrahësit e Shqipërisë. "Si çdo futbollist, në ato momente emocionet janë në një nivel tjetër, ku vetëm brenda fushës mund të kuptohen, është e vështirë ta përshkruash ndjenjën e të luajturit për këtë Kombëtare, për këta tifozë të mrekullueshëm që na japin dashni pa kufi, ashtu siç është dhe moto jonë, 'Shqipëri dashni pa kufi', ka shkruar ai.

Kërkimfalja e tij u publikua tek pasi u njoftua zyrtarisht se UEFA ka nisur



hetimet ndaj tij dhe Federatës së Shqipërisë për pretendimet për fyerje pas ndeshjes Shqipëri - Kroaci të mërkurën. UEFA ka caktuar një inspektor për t'i kryer hetimet "lidhur me sjelljen e mundshme raciste dhe diskriminuese nga tifozët, që dyshohet se kanë ndodhur në ndeshjen Kroaci - Shqipëri".

Gjasat janë të mëdha që FShF-ja dhe Federata kroate të gjobiten nga UEFA. Të dy federatat tashmë janë gjobitur për sjelljet e tifozëve të tyre në ndeshjet e xhiros së parë të "Euro

2024". Më i rëndë vlerësohet rasti i sulmuesit të Shqipërisë, Mirlind Daku. Pas ndeshjes me Kroacinë, Daku mori altoparantin dhe iu afrua tribunës ku ishin tifozët shqiptarë. Është dëgjuar duke nisur fyerje ndaj maqedonasve. Të enjten paradite Federata e Futbollit e Maqedonisë së Veriut doli me reagim zyrtar duke kërkuar nga Daku që të kërkojë falje dhe nga UEFA-ja që ta hetojë rastin. Rasti i Dakut u përmend edhe në letren e Federatës serbe për UEFA-n. Dhe UEFA do ta hetojë edhe atë.

Kosova U20 përfundon garat në turneun në Rumani

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Kosova U20 në konkurrencën e meshkujve ka marrë pjesë në turneun "Balkan International Tournament" në Cluj të Rumanisë. "Dardanët" e rinj në këtë turne kanë zhvilluar katër ndeshje, që u ndihmuan para garave ndërkombëtare. Të gjitha ndeshjet e Kosovës kanë qenë me rezultate të ngushta, derisa përzgjedhësi i Kosovës për U20, Dritëro Sefaja, ka parë formën e lojtarëve dhe paraqitjet e tyre para ndeshjeve ndërkombëtare. Në sfidën e parë Kosova fitoi ndaj



Bullgarisë me një pikë dallim, 71:72, derisa në ndeshjen e dytë pësoi nga Rumania 72:74. Në takimin e tretë në këtë turne, Kosova humbi nga Greqia 70:59, kurse në ndeshjen e fundit pësoi nga Bullgaria 62:68. Kosova U20 ka filluar përgatitjet më 10 qershor dhe do t'i vazhdojë në Prishtinë

para FIBA U20 Eurobasket, Divizioni B, që zhvillohet në Rumani më 12-21 korrik. Ndërkohë, Kosova U20 të meshkujt garojnë në Divizionin B, do të jetë në Grupin C, së bashku me Suedinë, Hungarinë, Armeninë, Ukrainën dhe Moldavinë.

REZULTATET

Bullgaria - Kosova	71:72
Kosova - Rumania	72:74
Greqia - Kosova	70:59
Kosova - Bullgaria	62:68

SHKURT

Lazio, gati 15 milionë euro për Manajn

Rey Manaj tregoi edhe njëherë se ka një potencial të madh, teksa në sezonin e tij të parë, me turqit e Sivassporit, u kthye në protagonistin e skuadrës, duke e mbyllur kampionatin me plot 18 gola, duke qëndruar kështu i treti në renditjen e golashënuesve të Turkiye Superlig, vetëm pas emrave si Edin Dzeko e Mauro Icardi. Falë kësaj Manaj po kërkohet nga një sërë ekipesh me emër në Evropë, ku më të interesuarit janë "Bardhekaltërit" e Lazios, të cilët janë gati të paguajnë plot 15 milionë euro vetëm për të sjellë në "Stadio Olimpico", "bomberin" shqiptar, mirëpo problemi qëndron te skuadra e Sivassporit. Këta të fundit janë tepër të kënaqur, me shifrën e ofruar nga "Bardhekaltrit", mirëpo në rast të disa performancave të mira radhazi, në Kampionatin Evropian të futbollit vlera e tij do të rritej edhe me tri sfida të mëdha para ndaj Italisë, Kroacisë e Spanjës, klubi turk ka vendosur "të rrezikojë", duke pritur fundin e "Euro 2024".

Trajneri i Spanjës: Dominuam në çdo aspekt ndaj Italisë

Spanja e mposhti Italinë me rezultat 1-0 dhe u kualifikua në fazën tjetër. Pavarësisht prej këtij suksesi, trajneri i Spanjës, Luis de la Fuente, kërkon që ekipi i tij të qëndrojë me këmbë në tokë pasi synon t'i shkojë deri në fund këtij Evropiani. "Dominuam ndaj Italisë në çdo aspekt, në çdo zonë. Nuk është e lehtë të 'fshish' një ekip si Italia. Kjo paraqitje më bën të besoj se kemi ende shanse reale për t'u përmirësuar, por duhet të qëndrojmë me këmbë në tokë, se ka ende rrugë të gjatë për të bërë", ka deklaruar De la Fuente.

Spalletti: Spanja ishte shumë më e fortë

Italia pësoi humbje nga Spanja (0-1), duke i komplikuar kështu fatet për kualifikimin. Pas ndeshjes, trajneri Luciano Spalletti u shpreh se Spanja kishte një ekip më të fortë dhe se kundër Kroacisë do të varet nga zgjedhjet që do të ketë në dispozicion. "Më mirë me Retegui dhe Zaccagni? Kur u bashkuam me tre ose katër lojtarë më të freskët arritëm të qëndronim më intensivë, duke krijuar veprime që mund të na kishin çuar në barazimin, por ata ishin shumë më të fortë se ne dhe fituan me meritë", ka thënë Spalletti. I pyetur se çfarë duhet kundër Kroacisë, Spalletti është përgjigjur: "Do të varet nga mënyra se si do të arrijmë atje, bazuar në zgjedhjet që kemi. Nëse nuk kemi zgjedhje, bëhet e vështirë".

Messi me Argjentinën e nisur me fitore Kupën e Amerikës

Argjentina e ka nisur me fitore mbrojtjen e titullit në Kupën e Amerikës. Leo Messi me shokë triumfuan 2-0 ndaj Kanadasë në duelin e parë të fazës së grupeve. Pjesa e parë u mbyll pa gola, ndërsa e dyta nisi me to. Ishte Julian Alvarez i cili realizoi në minutën e 49 të takimit pas asistimit të Mac Allisterit. E goli i dytë erdhi në momentet e fundit. Lautaro Martinez shënoi në minutën e 88 pas asistimit nga Leo Messi. Argjentina tani i prin Grupit A me tri pikë. Pos Kanadasë, në këtë grup gjenden edhe Peruja dhe Kili.

Verstappeni rikthehet në pistën ku shkroi emrin me të arta

Tetë vjet më parë Max Verstappeni mbërriti në Spanjë si një pilot i ri i Red Bullit dhe mundi konkurrencën duke arritur një fitore të parë historike në karrierë. Tani holandezi mbërrin në Barcelonë i freskët

nga suksesi numër 60 në Formula 1, i arritur vetëm dy javë më parë në Kanada. Tri herë kampioni i botës u shpreh i kënaqur para kësaj gare: "Unë e di se çfarë mund të bëj dhe skuadra e di se çfarë mund të bëj. Kështu që unë

fokusohe vetëm në performancën time. E di që kur jemi nën presion mund të bëjmë një punë të mirë, por padyshim që nuk jemi robotë". Duke folur për shiun, parashikimi i motit duket se e lë të hapur derën për

një garë të lagësht të dielën ashtu si në Kanada. Edhe kjo mundësi, megjithatë, duket se nuk i prish gjumin kampionit në fuqi, veçanërisht pas shfaqjes që ai bëri në Montreal: "Nuk ka rëndësi për mua". "Kur ka shi, si dhe

ndodhi në Kanada, mendoj se kemi treguar se mund të bëjmë mjaft mirë si ekip, në mënyrën se si punojmë. Kështu që nuk shqetësohem kurrë nëse ndodhin këta skenarë", ka thënë Max Verstappeni.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte


RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Jehona (Salih) Latifi shpall të pavlefshme Diplomën e Kolegjit AAB Prishtinë, Baçelor me nr. 1204/17.

- Metihe Behluli shpall të pavlefshme Diplomën e shkollës së mesme "28 Nëntori" të SH.M.T. Prishtinë.

- Arfeta Alija shpall te pavlefshme dëftesën e kl I - VIII shfmu " Ekrem Rexha Drini " Prizren.

- Arta Elshani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Brigada 125 " Medvec.

- Fatima Aslanagic shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni" Prizren.

- Valdrim Osmanollaj shpall te pavlefshme dokumentet duplikat shme " Ymer Prizreni" Prizren.

- Rinor Bojaxhiu shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Nazmi Kokollari " Prizren.

- Gone Sinanaj shpall të pavlefshme dëftesën nga kl. I-V të sh.f. "Rexhep Kadrijaj" Rastavic KK Deçan.

- Naronë Shaqir Xhukolli shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Dr. Ali Sokoli" Prishtinë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 912/1

Dt 21.06.2024

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, nenit 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, neni 81 i Ligjit për Zyrtar Publik Nr. 08/L-197, Udhëzimi Administrativ 14/2014, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2015, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2021, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Niveli	Institucioni/ Shkolla	Vendi	Pozita:	Vend i lirë/ Zëvendësim	Numri i pozitave
SHML	Qendra e Kompetencës "Shtjefën Gjeçovi" Prishtinë	Prishtinë	Mësimdhënës/e për Gjuhë Shqipe	Vend i lirë	2

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (**merret në Shkollë**);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diplomat e kualifikimit, **duhet të jenë të vërtetuara ose noterizuara**;
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, **duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI**;
- Certifikatat e noterizuara (certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë jo më të vjetra se gjashtë (6) muaj nga data e diplomimit);
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Certifikatën shëndetësore;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (**nëse ka**).

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (**Ligji Nr. 04/L-032, Ligji Nr. 04/L-138**) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të **MASHTI-it: UA Nr. 05/2015 dhe UA Nr. 05/2015**, si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Gjuhë Shqipe në shkollë të mesme të lartë:

- Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Bachelor (katërvjeçar 240 ECTS).

III. Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.

- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të silllet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

IV. Vlerësimi i kandidatëve

- Me këtë konkurs do të zhvillohen procedurat e rekrutimit për vitin shkollor 2024/2025 (Shtator 2024 – Gusht 2025);
- Kandidatët me kualifikime jo-përkatëse sipas ligjeve dhe UA të cekur në pikën II të këtij konkursi nuk do të merren në shqyrtim;
- Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheq 100 pikë apo deri në 50% të vlerësimit përfundimtar;
- Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohen intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë, kandidatët mund të vlerësohen në maksimum deri në 100 pikë apo 50% të vlerësimit përfundimtar;
- Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjedhen në pozitën e lartpërmendur;
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave do të njoftohen me e-mail dhe përmes telefonit.
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do të shpallen në tabelën e shpalljeve dhe do tu dërgohen kandidatëve me e-mail.

V. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes nga data 22.06.2024 deri me 21.07.2024.
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Shkollën përkatëse,
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim.
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse;
- Rezultatet e konkursit do të publikohen në tabelë të shpalljeve.
- Anëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe personat me afëtesi të kufizuar inkurajohen të aplikojnë në pozitën e shpallura në përputhje me kualifikimet përkatëse.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 911/1

Dt: 21.06.2024

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, nenit 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, neni 81 i Ligjit për Zyrat Publik Nr. 08/L-197, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2015, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2021, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita:	Vend i lirë/ Zëvendësim	Numri i pozitave
SHML	Qendra e Kompetencës "11 Marsi" në Prizren	Prizren	Mësimdhënës për lëndën Elektroteknikë profili TIT	Vendi lirë	1
SHML	Qendra e Kompetencës "11 Marsi" në Prizren	Prizren	Mësimdhënës për lëndën Elektroteknikë profili Instalues Elektrik	Vendi lirë	1
SHML	Qendra e Kompetencës "11 Marsi" në Prizren	Prizren	Mësimdhënës për lëndën Makinerisë, profili INK	Vendi lirë	1
SHML	Qendra e Kompetencës "11 Marsi" në Prizren	Prizren	Mësimdhënës për lëndët Ekonomi dhe Ndërmarrësi (menaxhim i projekteve)	Vendi lirë	1
SHML	Qendra e Kompetencës "11 Marsi" në Prizren	Prizren	Instruktur të Dizajnit të Tekstilil dhe Veshjes	Vendi lirë	1
SHML	Qendra e Kompetencës "11 Marsi" në Prizren	Prizren	Instruktur të Makinerisë, profili INKU	Vendi lirë	1
SHML	Qendra e Kompetencës "Shtjefën Gjeçovi", në Prishtinë	Prishtinë	Instruktur të Ekonomisë dhe Ndërmarrësi	Vendi lirë	1
SHML	Qendra e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" në Malishevë	Malishevë	Instruktur për lëndët e profilit të Administratës	Vendi lirë	1
SHML	Qendra e Kompetencës "11 Marsi" në Prizren	Prizren	Instruktur të Ekonomisë dhe Ndërmarrësi	Vendi lirë	1

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në Shkollë);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diplomat e kualifikimit, duhet të jenë të vërtetuara ose noterizuara;
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI;
- Certifikatat e noterizuara (certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë jo më të vjetra se gjashtë (6) muaj nga data e diplomimit;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Certifikatën shëndetësore;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).
- Për instruktor me së paku 5 vite përvojë pune në profesion në ndërmarrje, biznese dhe institucione tjera.

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 04/L-032, Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHTI-it: UA Nr. 05/2015 dhe UA Nr. 05/2015, si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës/e për fushën e Elektroteknikë profili TIT

- MSc. i elektroteknikës – inxhinierisë kompjuterike / shkencave kompjuterike
- Inxh. i dipl. i elektroteknikës /elektronikës

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës/e për lëndën Elektroteknikë profili Instalues Elektrik

- Msc. i elektroteknikës / elektroenergjetikë
- Inxh. i dipl. i elektroteknikës/ elektroenergjetikë

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës/e për fushën Makinerisë, profili INKU

- Msc. i makinerisë / termoenergjetikë
- Inxh. i dipl. i makinerisë / termoenergjetikë

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës/e për lëndët Ekonomi dhe Ndërmarrësi (menaxhim i projekteve dhe Ekonomi dhe Ndërmarrësi)

- Msc. i ekonomisë
- Ecc i dip i ekonomisë

Kriteret e kualifikimit për instruktor për lëndën Dizajnit të Tekstilil dhe Veshjes

- Përgatitje/kualifikim bachelor

Kriteret e kualifikimit për instruktor të Makinerisë, profili INKU

- Përgatitje/kualifikim bachelor

Kriteret e kualifikimit për instruktor të Ekonomisë dhe Ndërmarrësi

- Përgatitje/kualifikim bachelor

Kriteret e kualifikimit për instruktor për lëndët e profilit të Administratës

- Përgatitje/kualifikim bachelor

III. Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Detyrat dhe Përgjegjësitë për Instruktur:

- Instruktur është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e teorisë dhe praktikës profesionale.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të praktikës profesionale dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

IV. Vlerësimi i kandidatëve

- Me këtë konkurs do të zhvillohen procedurat e rekrutimit për vitin shkollor 2024/2025 (Shtatori 2024 – Gusht 2025);
- Kandidatët me kualifikime jo-përkatëse sipas ligjeve dhe UA të cekur në pikën II të këtij konkursi nuk do të merren në shqyrtim;
- Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheq 100 pikë apo deri në 50% të vlerësimit përfundimtar;
- Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohen intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë, kandidatët mund të vlerësohen në maksimum deri në 100 pikë apo 50% të vlerësimit përfundimtar;
- Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjedhjen në pozitë e lartpërmendura;
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave do të njoftohen me e-mail dhe përmes telefonit.
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do të shpallen në tabelën e shpalljeve dhe do tu dërgohen kandidatëve me e-mail.

V. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga data e shpalljes nga data 22.06.2024 deri me 21.07.2024.
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Shkollën përkatëse,
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim.
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse;
- Rezultatet e konkursit do të publikohen në tabelë të shpalljeve.
- Anëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe personat me afëtesi të kufizuar inkurajohen të aplikojnë në pozitë e shpallura në përputhje me kualifikimet përkatëse.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1909

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
0.5L



TRADITË QË NGA 1992

